




Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

Odeljenje za Privreda, Razvoj i Turizam

Department of Economy, Development and Tourism



Nr. i prot. 4008 Më 02.10.2020 Dt. 2020  
-III- Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

## THIRRJE PËR APLIKIM

### 1. Skema e granteve "Përkrahja e përpunuesve dhe pikave grumbulluese të qumështit në komunën e Rahovecit"

Komuna e Rahovecit me lansimin e skemës së granteve për përkrahjen e zhvillimit të ndërmarrësisë do të ndihmojë në plotësimin e nevojave të të bërit biznes. Kjo skemë e granteve do të mundësojë që projektet cilësore biznesore të implementohen dhe zhvillohen më tej, duke krijuar kështu vende të reja pune. Këto vende të reja të punës do të gjenerohen nga rritja e ndërmarrjeve ekzistuese që veprojnë në sektorët me potencial më të madh për zhvillim.

### 2. Synimet e thirrjes për projekt propozim

Synimi i përgjithshëm i thirrjes është zhvillimi ekonomik lokal i balancuar përmes përkrahjes së zhvillimit të bizneseve në sektorin e qumështit dhe zhvillimit ekonomik në komunën e Rahovecit.

**Synimet specifike** të kësaj Thirrjeje për aplikim janë:

- i. Gjenerimi i vendeve të reja të punës.
- ii. Zhvillimi i ndërmarrësisë që kontribuon direkt në zhvillimin e sektorit të qumështit.

### 3. Përkrahja financiare e ofruar nga autoriteti kontraktues

Shuma e përgjithshme e përkrahjes për këtë thirrje është **13,000.00 €**

Grandi do të jepet për: **Përpunues dhe pikat grumbulluese të qumështit në komunën e Rahovecit.**

**-Përkrahja do të jetë e ndarë kategori, varësish nga sasia e grumbulluar e qumështit :**

- Kategoria e parë nga një (1) deri në tre (3) milion litra qumësht.
- Kategoria e dytë nga tre (3) deri në pesë (5) milion litra qumësht.

## **4. Kualifikimi i aplikanteve: kush mund të aplikojë?**

Për t'u kualifikuar për grand, aplikanti/ja duhet:

- Të jetë shtetas të Republikës së Kosovës, banor rezident i komunës së Rahovecit (dëshmohet me kopje të letërnjoftimit),
- Bizneset e regjistruesit duhet që të kenë të shlyera të gjitha obligimet ndaj Komunës së Rahovecit,
- Të jetë pika grumbulluese ose përpunues të qumështit( të dëshmohet me dokument )

## **5. Lokacioni**

Projekti duhet të realizohet në territorin e komunës së Rahovecit.

### **Dokumentet e nevojshme për aplikim**

- Formulari i aplikimit
- Certifikata e biznesit së bashku me informatat
- ID e pronarit
- Vërtetim qe i ka të shlyera obligimet ndaj Komunës së Rahovecit
- Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së
- Konfirmimin e xhirolllogarisë bankare
- Projekt propozimi
- Sasia e qumështit e grumbulluar ( të dëshmohet me sasinë e grumbulluar për vitin 2020).

## **6. Kriteret dhe vlerësimi**

- Të jetë biznes i regjistruar (aktiv ne ARBK) në komunën e Rahovecit.
- Të jetë biznes i lecencuar si pikë grumbulluese ose përpunuese e qumështit.
- Kategoria e parë nga një (1) deri në tre (3) milion litra qumësht.
- Kategoria e dytë nga tre(3) deri në pesë milion litra qumësht, vlera e përkrahjes

Vlerësimi i aplikacioneve do të përfshijë kontrollin administrativ, kontrollin e kualifikueshmërisë dhe vlerësimin final. Procesi i kontrollit teknik do të vlerësojë nëse aplikuesi ka paraqitur dokumentet e këruara me këtë udhëzues, kontrolli i kualifikueshmërisë do të vlerësojë nëse aplikuesi ka respektuar kriteret e kualifikueshmërisë dhe vlerësimi final i cili do të vlerësoj në bazë të kritereve për vlerësim. Grandi do t'i jepet aplikanteve (me notë më të lartë), deri në kufijtë e buxhetit në dispozicion.

## **7. Shpenzimet e pranueshme**

- Investimet në asete të prekshme që kanë të bëjnë me blerjen e pajisjeve, makinerisë, linjat e prodhimit, përmirësimin e proceseve dhe metodave prodhuase dhe përpunuese;

## **8. Mënyra e Aplikimit**

Aplikacioni mund te shkarkohet ne WEB-faqe të Komunës së Rahovecit, ose të tërhiqet në zyrat e Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

Aplikacionet e plotësuara duhet dorëzuar në adresën:

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, Komuna e Rahovecit

Rr. "Sheh Myhedini" pn, Objekti i ri. Kati i parë (I).

## **9. Afati për dorëzimin e aplikacionit të plotë.**

Afati për dorëzimin e aplikacioneve është nga data: 05 deri me 16 tetor 2020.